

VENDIM
Nr.428, datë 21.3.2006

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“TEPELENA SAT”

PERSONIT FIZIK: Z. DRITAN MEMUSHI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurën e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televisionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik, z.Dritan Memushi licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televisionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës për të penetruar në qytetin e Tepelenës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj